



SHERBIMI SOCIAL

#TRAJNIMET DHE MODERNIZIMI I SKEMËS SË NDIHMËS EKONOMIKE



Gjatë muajit Shkurt, në vijim të përpjekjeve për modernizimin e asistencës sociale, është zhvilluar një tjetër trajnim 2 ditor me profesionistët e Drejtorive Rajonale të Shërbimit Social Shtetëror.

Fokusi i këtij trajnimi të mbajtur pranë Drejtorisë së Përgjithshme të SHSSH ishte skema e Ndhmës Ekonomike dhe metodologjia e re e kontrollit.

Ky trajnim rrit nivelin e aftësive të profesionistëve që punojnë në këtë fushë dhe garanton zbatimin e drejtë të legjislacionit në fuqi.

#PUNËSIMI ËSHTË E VETMJA ZGJIDHJE E QËNDRUESHME



Fationa ka përfituar shërbime sociale dhe shëndetësore prej 5 vitesh në Qendrën e Zhvillimit Durrës. Gjatë këtyre viteve ajo ka ndjekur rregullisht shkollën speciale dhe kurse të ndryshme profesionale në Qendrën e Formimit Profesional Publik, për të cilat është certifikuar.

Fationa është 29 vjeç dhe duke qënë se ka mbushur moshën e qëndrimit në qendër, iu ofrua punësim me kohë të pjesshme si sanitare në mënyrë që ajo të ri-integrohet sa më shpejt në shoqëri.



SHERBIMI SOCIAL

#DREJTORIA E KONTROLLIT TË PAGESAVE TË NE DHE PAK



Drejtoria e Kontrollit të Pagesave të NE dhe PAK ka monitoruar kontrollet e kryera nga Drejtoritë Rajonale sipas planifikimit të bërë për muajin. Është përgatitur raporti i vlerësimit të situatës së skemës së NE dhe janë nxjerrë raporte të veçanta për secilin qark.

Gjithashtu, Drejtoria e Kontrollit të Pagesave të NE dhe PAK ka kryer kontroll në Drejtorinë Rajonale Durrës lidhur me zbatimin e legjislacionit për Ndihmën Ekonomike dhe metodologjinë e re të kontrollit si edhe zbatimin e legjislacionit për PAK në periudhën Janar-Dhjetor 2018.

#DREJTORIA E SHËRBIMEVE SOCIALE

Gjatë muajit Shkurt, Drejtoria e Shërbimeve Sociale ka kryer 24 vlerësime social-ekonomike të fëmijëve të pashoqëruar. Është vlerësuar dokumentacioni për sistemimin e 8 fëmijëve në institucionet e përkujdesit. Janë sistemuar në institucione të përkujdesit shoqëror 2 fëmijë me aftësi të kufizuara.

Në lidhje me të moshuarit janë shqyrtuar 15 dosje, nga të cilët janë sistemuar në institucion 10 të moshuar dhe janë transferuar 3 të moshuar të tjerë.

Janë shqyrtuar dokumentacionet për rinovimin e 68 librezave të Statusit të Jetimit. Në lidhje me Viktimat e Trafikimit është menaxhuar 1 rast i ri.





SHERBIMI SOCIAL

#INSTITUCIONET E PËRKUJDESIT SHOQËROR



Shtëpia e të Moshuarve Shkodër tashmë i ofron të gjitha për përfituesit e saj. Institucioni iu nënshtrua rikonstruksionit të plotë disa muaj më parë, duke përmirësuar në këtë mënyrë standardet e shërbimeve që ofron.

Përveç rikonstruksionit, tashmë në Shtëpinë e të Moshuarve Shkodër ofrohet një paketë e plotë shërbimesh që përfshin shërbimin psiko-social, shërbimin ambulator dhe kushtet për kryerjen e gjimnastikës për përfituesit.

Të gjitha këto ndryshime janë kryer në funksionon të garantimit të një shëndeti të shkëlqyer për gjyshërit përfitues.